

**Data 29.12.2022**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE  
TEKNIKE DHEKRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karrotrec” për Policinë Bashkiake.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): ):** Artikuj te ndryshem

**VLERA E FONDIT LIMIT: 14.497.483,33 (katërmbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre presje tridhjetë e tre) lekë pa tvsh,**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

c. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*

d. *Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdëklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet

*publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

**2.2.2** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2019, 2020, 2021) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet përkatësisht 14.497.483,33 (katërmëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre presje tridhjetë e tre) lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

*“ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe për*

*këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

*Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3(tre) vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 5.798.993,33 (pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre presje tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Faturat duhet të jenë të nënshkruara nga Blerësi dhe Shitësi.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

*Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së pajisjeve (jo më pak se një vit), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e tyre pa pagesë konform specifikimeve teknike. Operatori ekonomik do të marrë përsipër zëvendësimin e cdo pjese të karrotrecit në rast defekti që vjen nga prodhuesi për një periudhë 1 vjecare nga dita e dorëzimit të mallit.

***Argumentimi:** Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe të mbulohen demtimet brenda periudhes se garancise. Kriteri i kerkuar në lidhje me deklaraten, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Servisi i cdo pjese të karrotrecit brenda garancisë garanton menaxhimin dhe trajtimin e shpejtë të cdo pjese në rast nevojë riparimesh fizike si edhe cilësinë e ndërhyrjes së mundshme në pajisje. Koha e riparimeve fizike është shumë e rëndësishme për rikthimin e pjeseve te karrotrecit në punë dhe vazhdimin e procesit të punes.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nëpërmjet së cilës do të deklarojë se merr përsipër pagesat e të gjitha detyrimeve ndaj DPSHTRR, se mjeti do të jetë i pajisur me siguracion TPL dhe KASKO deri në fund të vitit 2023 dhe se do të kryejë transferimin e pronësisë për Bashkinë Tiranë. Gjithashtu operatori ekonomik do të deklarojë se merr përsipër logimin me ngjyra të Bashkisë Tiranë me mbishkrimin “Policia Bashkiake” në mjet si dhe të deklarojë se do të marrë përsipër furnizimin dhe vendosjen e një feneline në mjet.

***Argumentimi:** Kjo deklaratë është kërkuar pasi kërkohet që mjeti të merret në dorëzim me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të qënë funksional edhe operativ. Gjithashtu kërkohet të bëhet logimi me ngjyra të Bashkisë Tiranë me mbishkrimin “Policia Bashkiake” në mënyrë që të bëhet identifikimi i këtij mjeti që i përket institucionit të Bashkisë Tiranë.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar mbi të drejtat e realizimit të furnizimit, shërbimit të mirëmbajtjes për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë aktin e marrëveshjes midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përvecse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/ broshurë dhe/ose skedat teknike të mjetit objekt prokurimi me qëllim përmbushjen e specifikimeve (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura dhe/ose skedat teknike, duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 5 të DST

**Argumentimi:** Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet

teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalentii tij/saj”.

*Specifikime teknike: për Blerje karrotrec për Policinë Bashkiake*

*Mjeti duhet të jetë detyrimisht i ri, 0 km.*

*Preferohet viti i prodhimit 2022*

*Mjeti te jetë me kamio manual dhe lloji i karburantit naftë.*

*Kapaciteti ngritës të jetë minimalisht 3000 kg dhe të ngrejë dhe mjete të tonazhit të rëndë.*

*Mekanizmi ngritës: Të ketë sistem ngritës me dy kulla me 4 pirun anësorë.*

*Drejtimi i punës: Djathtas edhe majtas*

*Kontrolli: Kontrolli i levës dhe valvolave*

*Shufrat e pistonit të cilindrit të jenë të përbëra nga materialet çelik inox krom.*

*Pompa hidraulike e drejtuar nga PTO*

*Të ketë ndriçim nate LED dhe dritë fener*

*Shoqëritë ofertuese duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së mjetit (jo më pak se një vit) gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike. Operatori ekonomik do të marrë përsipër zëvendësimin e cdo pjese të karrotrecit në rast defekti që vjen nga prodhuesi për një periudhë 1 vjecare nga dita e dorëzimit të mallit.*

*Mjeti duhet të jetë detyrimisht i papërdorur më parë me 0 km*

*Operatori ekonomik fitues merr përsipër pagesat e të gjitha detyrimeve ndaj DPSHTRR, të jetë i pajisur me siguracion TPL dhe KASKO deri në fund të vitit 2023 dhe transferimin e pronësisë për Bashkinë Tiranë.*

*Operatori ekonomik fitues merr përsipër edhe logimin e karrotrecit me logon me ngjyra të Bashkisë Tiranë dhe me mbishkrimin POLICIA BASHKIAKE.*

*Operatori ekonomik fitues merr përsipër furnizimin dhe vendosjen e një feneline në mjet.*

*Bashkelidhur foto ilustruese.*

*Nisur nga fakti që fondi që përdoret për blerjen e karrotrecit është investim do të thotë që ky mjet do të jetë në inventarin e Policisë Bashkiake për një kohë të gjatë prandaj kërkohet që mjeti të jetë detyrimisht i ri me kilometrazh 0 km si dhe preferohet viti prodhimit 2022).*

*Gjendja e karburantit që ndodhet në magazinën e bashkisë Tiranë është naftë prandaj kërkohet që mjeti të plotësojë këtë kusht. Ky mjet do të jetë në qarkullim për mbulim të përgjithshëm të qytetit të Tiranës ku mjetet që mund të bllokohen mund të jenë të peshave të ndryshme prandaj është kërkuar që kapaciteti ngritës të jetë minimalisht 3000 kg.*

*Është kërkuar specifikimi që karrotreci të ketë sistem ngritës me dy kulla me pirun anësor në mënyrë që të krijohet lehtësi gjatë ngarkesës së mjetit të bllokuar në karrotrec. Për sa i përket kërkesave të tjera janë përcaktime mëse normale dhe që shërbejnë për mirëfunksionimin e karrotrecit.*

*Kërkesat/specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.*

*Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 16.01.2023, ora 13.00.*